TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. I/50
Dt. 29.04.2025
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH.A.
KOMISIONI I AUDITIMIT

STATUT
I KOMISIONIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Fushë Kosovë
Prill 2025

Shkurtesat dhe sqarimet

Shkurtesa	Kuptimi
AB	Auditor i Brendshëm
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
KA	Komisioni i Auditimit
LKBFP	Ligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike
LNP	Ligji për Ndërmarrje Publike
ME	Ministria e Ekonomisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NP	Ndërmarrje Publike
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
Standardet	Standardet Ndërkombëtare për Praktiken Profesionale të Auditorëve të Brendshëm
ZAB	Zyrtari për Auditim të Brendshëm (Drejtori i NJAB)
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Sqarimet
Njësia e Auditimit të Brendshëm – nënkupton Njësinë e Auditimit të Brendshëm sipas kuptimit të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike
Kryeshefi Ekzekutiv – nënkupton Zyrtarin Kryesor Administrativ të Ndërmarrjes
Komisioni i Auditimit – nënkupton Komitetin e Auditimit të Brendshëm sipas kuptimit të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe është i barasvlershëm me të.
Ndërmarrja – nënkupton HK-Trainkos Sh.A.

PËRMBAJTJA

1. SHKURTESAT DHE SQARIMET....2
2. HYRJE....4
3. MISIONI....4
4. QËLLIMI....4
5. AUTORITETI....5
6. PËRBËRJA....5
7. TAKIMET/MBLEDHJET....6
8. QASJA NË KOMISIONIN E AUDITIMIT....6
9. RAPORTIMI....6
10. BASHKËPUNIMI ME PALËT KRYESORE....7
11. PËRGJEGJËSITË....7
    - 11.1 Pasqyrat Financiare....7
    - 11.2 Kontrolli i Brendshëm....8
    - 11.3 Menaxhimi i Rrezikut....8
    - 11.4 Funksioni i Auditimit të Brendshëm....8
    - 11.5 Performanca e Auditorëve të Jashtëm....8
    - 11.6 Pajtueshmëria....9
    - 11.7 Përgjegjësitë raportuese....9
    - 11.8 Përgjegjësi të tjera....9
12. KËRKESAT PËR INFORMACIONE....10
13. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE....10

Bazuar në Nenin 4 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Paragrafin 4 të Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ -Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik si dhe duke pasur parasysh nenet 14, 24, 25, 26, 27 dhe 34 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A., në Mbledhjen Nr. 22, të mbajtur më 29.04.2025, miraton këtë:

STATUT
TË KOMISIONIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM TË HK-TRAINKOS SH.A.

1. HYRJE

Ky Statut është hartuar në bazë të statutit model të udhëzuar nga MFPT, i cili përfshinë shumicën e praktikave më të mira, bashkëkohore Evropiane dhe të Amerikës Veriore si dhe duke u bazuar në rrethanat e Ndërmarrjes dhe në legjislacionit për NP, ku përcaktohen roli, përgjegjësia, funksioni dhe kompetencat e Komisionit të Auditimit të Brendshëm të HK-Trainkos Sh.A.

Duke pasur parasysh se ky Statut i është përshtatur nevojave të HK-Trainkos Sh.A., në të cilin janë përfshirë aktivitetet e mundshme të auditimit, nuk do të ishte relevant për një komitet apo ndërmarrje tjetër.

2. MISIONI

Komisioni i Auditimi të Brendshëm është aktivitet i pavarur, objektiv dhe këshillues, i themeluar për t'i shtuar vlerë Ndërmarrjes si dhe për të përmirësuar aktivitetin dhe sistemin e kontrolleve të brendshme të saj.

3. QËLLIMI

Me qëllim të zbatimit të strategjive dhe politikave të Aksionarit, që HK-Trainkos Sh.A. përmes një sistemi të qëndrueshëm të qeverisjes korporative të zhvillojë afarizmin e vet, do të përkrahet Bordi i Drejtorëve në përmbushjen e përgjegjësive mbikëqyrëse në procesin e raportimit financiar, sistemin e kontrollit të brendshëm dhe proceset tjera të monitorimit të pajtueshmërisë me ligjet dhe aktet tjera të brendshme të Ndërmarrjes.

Në mënyrë specifike, përveç tjerash, mbështetja për Bordin apo Aksionarin do të përfshijë përmbushjen e përgjegjësive për çështjet si në vijim:

- Integritetin dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare;
- Pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore;
- Kontrollin e brendshëm të financave;
- Menaxhimin e rrezikut;
- Efikasitetin dhe objektivitetin e funksioneve të auditimit të brendshëm; dhe
- Performancën e funksionit të auditimit të brendshëm dhe auditorëve të jashtëm.

4. AUTORITETI

Komisioni i Auditimit ka autoritetin dhe përgjegjësinë që të:

- Sigurojë se menaxhmenti i lartë dhe personeli i HK-Trainkos Sh.A. zbatojnë me kohë rekomandimet e bëra nga Njësia e Auditimit të Brendshëm;
- Kërkojë apo lejoj që Njësia për Auditim të Brendshëm të vlerësojë shkallën deri në të cilën janë zbatuar rekomandimet e mëparshme dhe shkallën e ndonjë përmirësimi që ka rezultuar;
- Raportojë të gjitha instancat e ndonjë dyshimi për shkelje ligjore tek autoritetet publike përkatëse;
- Sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm është e pavarur dhe e lirë nga ndërhyrja e menaxhmentit në operacionet të cilat auditohen;
- Hetojë ndonjë ndërhyrje të pretenduar, refuzim apo rezistim të aktiviteteve të ligjshme të auditimit të brendshëm dhe përnjëherë të ndreqin atë sjellje përfshirë ndërmarrjen e masave dhe veprimeve disiplinore apo adresimin për ndërmarrjen e tyre;
- Kërkojë që ZAB të dorëzojë planet e auditimit për miratim;
- Mbikëqyrë Njësinë e Auditimit të Brendshëm në zhvillimin dhe ekzekutimin e planeve të saj strategjike dhe vjetore;
- Kërkojë nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të dorëzojë raportet lidhur me pajtueshmërinë dhe sistemet e kontrollit si edhe rekomandimet që rezultojnë nga aktivitetet e auditimit të brendshëm;
- Kërkojë nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të dorëzojë raportet vjetore lidhur me aktivitetet e auditimit të brendshëm; dhe
- Mbajë të gjitha dokumentet në lidhje me secilin auditim, sikur edhe ndonjë auditim të suspenduar.

5. PËRBËRJA

Përbërja e Komisionit të Auditimit është sipas kërkesave të LNP dhe në përputhje edhe me Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Komisioni i Auditimit është emëruar (formuar) në bazë të Vendimit të ME-së Nr. **01/724**, të datës **29.01.2024**, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Ndërmarrje Publike.

Anëtarët e Komisionit të Auditimit janë të emëruar nga mesi i drejtorëve të Bordit dhe përfundimi i angazhimit të tyre në Komision të Auditimit është i lidhur me përfundimin e mandatit të Bordit të Drejtorëve apo me vendim të Ministrisë së Ekonomisë-Aksionarit. Përfundimi i mandatit të rregullt të Bordit të Drejtorëve, përkatësisht i Komisionit të Auditimit është më **10.01.2027**.

Komisioni i Auditimit është në këtë përbërje:

1. Z. Ruzhdi Zeqiri, Kryesues;
2. Znj. Kimete Fazliu, Anëtare;
3. Znj. Luljeta Lutfiu, Anëtare.

6. TAKIMET/MBLEDHJET

Komisioni do të takohet së paku një herë në muaj, në bazë të rrethanave mund të ketë edhe takime shtesë. Të gjithë anëtarët e Komisionit pritet të marrin pjesë në çdo mbledhje, fizikisht apo nëpërmjet audio ose video-konferencës.

Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe përfaqësuesi i Zyrës Kombëtare të Auditimit, sipas nevojës, mund të ftohen që të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit të Auditimit. Po ashtu, Komisioni i Auditimit mund të ftojë zyrtarë të tjerë të Ndërmarrjes që të marrin pjesë në mbledhje, për të ndihmuar me diskutime për ndonjë çështje.

Komisioni i Auditimit mund të kërkojë nga ndonjëri apo nga të gjithë pjesëmarrësit e mbledhjes, të cilët nuk janë anëtarë të Komisionit, që të tërhiqen nga mbledhja në çfarëdo kohe që të lehtësojnë diskutimet e hapura për çështje të caktuara.

Shumica e anëtarëve të Komisionit e përbëjnë kuorumin dhe shumica e kuorumit është e nevojshme për çdo rekomandim ose veprim tjetër të Komisionit.

Agjendat e takimit do të përgatiten dhe sigurohen paraprakisht për anëtarët, së bashku me materialet e duhura informuese. Pas çdo takimi do të përgatiten procesverbalet përkatëse.

Kryeshefi Ekzekutiv, apo Bordi i Drejtorëve mund të kërkojnë nga Komisioni i Auditimit që të thërrasin edhe mbledhje tjera për të diskutuar ndonjë çështje të caktuar, për të cilat kërkojnë këshilla nga Komisioni.

7. QASJA NË KOMISIONIN E AUDITIMIT

Zyrtari për Auditim të Brendshëm, Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve do të kenë qasje të lirë dhe konfidenciale te Kryesuesi i Komisionit të Auditimit.

8. RAPORTIMI

Komisioni i Auditimit, pas çdo mbledhje, do të raportojë zyrtarisht me shkrim në mbledhjen e radhës së Bordit të Drejtorëve për vendimet dhe rekomandimet e Komisionit si dhe për të adresuar çështjet që do të paraqiten për sa i përket:

- Cilësisë dhe integritetit të pasqyrave financiare;
- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret dhe
- Performancës dhe pavarësisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Komisioni i Auditimit do të përgatisë Raportin Vjetor për Ministrinë e Ekonomisë-Aksionarin ku përshkruhet përbërja e Komisionit, përgjegjësitë dhe si kryhen ato, si dhe informatat e tjera relevante, përfshirë edhe rishikimin e nivelit të lartë të përshtatshmërisë dhe pranueshmërisë së:

- Procesit për vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut, kontrollin e brendshëm dhe përgjegjësinë;
- Politikat e kontabilitetit;
- Pasqyrat financiare;
- Efikasitetin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm; dhe

- Përgjigjen e menaxhmentit për sa i përket çështjeve të identifikuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe auditori i jashtëm (nëpërmjet të Letrës së Menaxhmentit).

9. BASHKËPUNIMI ME PALËT KRYESORE

- Komisioni i Auditimit bashkëpunon me Bordin e Drejtorëve, Zyrtarin Kryesor Financiar, auditorët e brendshëm dhe me Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me rishikimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike dhe rekomandimet e dhëna.
- Komisioni i Auditimit mund të mbajë takime me akterët e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni ku diskuton për raportet përmbledhëse periodike të aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe jashtëm, raportin vjetor të aktiviteteve të audituara dhe menaxhimin financiar e kontrollin.
- Pas çdo takimi të realizuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, Komisioni i Auditimit raporton tek Bordi i Drejtorëve duke përmbledhur aktivitetet e ndërmarra dhe ofruar këshilla për veprimet e mëtejshme.
- Komisioni i Auditimit ofron qasje të plotë dhe të papenguar te të gjitha të dhënat ose raportet e hartuara dhe të mirëmbajtura nga Komisioni i Auditimit, pas kërkesës së Zyrës Kombëtare të Auditimit ose autoriteteve të tjera publike të ngarkuara me funksione hetuese ose kontrolli.

10. PËRGJEGJËSITË

Sikurse edhe në ligjin për NP 03/L-087, Komisioni i Auditimit është përgjegjës që të ofrojë mbikëqyrje në fushat e mëposhtme:

10.1 Pasqyrat Financiare

- Shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportimit, duke përfshirë transaksione të ndërlikuara ose të pazakonshme dhe fusha me nivel të lartë të gjykimit, si dhe deklaratat e fundit profesionale dhe rregullative, dhe të vlerësojë ndikimin e tyre në pasqyrat financiare.
- Së bashku me menaxhmentin dhe auditorët e jashtëm do të rishikojë rezultatet e auditimit, duke përfshirë vështirësitë e hasura.
- Rishikimin e pasqyrave vjetore financiare dhe vlerësimin e tyre nëse ato janë të plota, në përputhje me informacionin e njohur për anëtarët e Komisionit dhe nëse pasqyrojnë parimet e duhura të kontabilitet.
- Monitorimin e raporteve tjera financiare.
- Të rishikojë me menaxhmentin dhe auditorët e jashtëm të gjitha çështjet që kërkohen t'i komunikohen Komisionit sipas standardeve të përgjithshme të pranuara të auditimit.
- Të trajtojë informacionin e përkohshëm financiar të zhvilluar nga menaxhmenti, si dhe natyrën dhe shkallën e përfshirjes së auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm.
- I rekomandon Ndërmarrjes të mbajë dhe të zbatojë procedura të brendshme për menaxhimin e aktiviteteve, si dhe shqyrton dhe vlerëson zbatimin dhe pajtueshmërinë për këto procedura.

- Përzgjedhë dhe emëron Zyrtarin për Auditim të Brendshëm dhe monitoron veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm.
- Jep rekomandim për emërimin e auditorëve të jashtëm dhe monitoron pavarësinë e tyre.

10.2 Kontrolli i Brendshëm

- Të konsiderojë efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të Ndërmarrjes, duke përfshirë sigurinë dhe kontrollin e teknologjisë informative.
- Të kuptojë fushëveprimin e auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm mbi rishikimin e kontrollit të brendshëm për raportimin financiar dhe të pranojë raporte mbi gjetjet dhe rekomandimet e rëndësishme, së bashku me përgjigjet e menaxhmentit.

10.3 Menaxhimi i Rrezikut

- Të diskutojë me menaxhmentin politikat kryesore për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut.

10.4 Funksioni i Auditimit të Brendshëm

- Të rishikojë me menaxhmentin dhe Zyrtarin për Auditim të Brendshëm statutin, aktivitetet, personelin dhe strukturën organizative të funksionimit të auditimit të brendshëm.
- Ka autoritetin përfundimtar për të rishikuar dhe miratuar planin vjetor të auditimit dhe të gjitha ndryshimet kryesore në plan.
- Të sigurojë që të mos ketë restrikcione apo kufizime të paarsyeshme, të rishikojë dhe të emërojë, zëvendësojë apo shkarkojë Zyrtarin për Auditimit të Brendshëm.
- Së paku një herë në vit, të rishikojë performancën e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm dhe të përcaktojë kompensimin e tij.
- Të shqyrtojë efektivitetin e funksionimit të auditimit të brendshëm, duke përfshirë pajtueshmërinë me Kornizën Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm që përbëhet nga Përkufizimi i Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës dhe Standardet.
- Raportimi i mashtrimit potencial apo praktikave të korruptimit te autoritetet e caktuara.
- Në baza të rregullta kohore, takohet veçmas me Zyrtarin për Auditim të Brendshëm për të diskutuar çdo çështje që Komisioni ose Njësia e Auditimit të Brendshëm vlerësojnë se duhet të diskutohen veçmas.

10.5 Performanca e Auditimit të Jashtëm

- Të rishikojë qasjen dhe fushëveprimin e propozuar nga auditimi i jashtëm, duke përfshirë koordinimin e punëve ndërmjet auditimit të jashtëm me auditimin e brendshëm duke përfshire edhe auditimin nga ZKA-ja.
- Të shqyrtojë performancën e auditorëve të jashtëm dhe dhënien e pëlqimit

përfundimtar për emërimin ose shkarkimin e auditorëve.

- Të rishikojë dhe konfirmojë pavarësinë e auditorëve të jashtëm, duke marrë deklarata nga auditorët mbi raportet në mes të auditorëve dhe Ndërmarrjes, duke përfshirë shërbimet jo audituese, dhe diskutimin e marrëdhënieve me auditorët.
- Në baza të rregullta kohore, të takohet veçmas me auditorët e jashtëm për të diskutuar për çdo çështje që Komisioni ose auditorët besojnë se duhet të diskutohet veçmas.

10.6 Pajtueshmëria

- Rishikimi i efektivitetit të sistemit për monitorimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe rezultatet e hetimit të menaxhmentit si dhe ndërmarrjen e masave për përmirësim apo adresimin për ndërmarrje të veprimeve disiplinore në rastet e mospajtueshmërisë.
- Rishikimi i gjetjeve të çdo ekzaminimi nga institucionet/agjencitë rregullatorë, dhe çdo auditor.
- Rishikimi i procesit të komunikimit të Kodit të Etikës tek personeli i Ndërmarrjes, dhe monitorimin e pajtueshmërisë me të.
- Pranon përditësime të rregullta nga menaxhmenti dhe këshilluesit ligjorë të Ndërmarrjes lidhur me çështjet e pajtueshmërisë.

10.7 Përgjegjësitë raportuese

- Raporton rregullisht në Bordin e Drejtorëve për aktivitetet e Komisionit çështjet e lidhura me rekomandimet.
- Siguron mënyrë të hapur të komunikimit ndërmjet auditimit të brendshëm, auditorëve të jashtëm dhe Bordit të Drejtorëve.
- Një herë në vit raporton te Aksionari ose sipas nevojës, duke përshkruar përgjegjësitë dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga rregullativa, përfshirë miratimin e shërbimeve jo audituese.
- Rishikimi i çdo raporti të Ndërmarrjes që ndërlidhet me përgjegjësitë e Komisionit.

10.8 Përgjegjësi të tjera

- Kryen aktivitete të tjera që lidhen me këtë statut ashtu siç kërkohet nga Bordi i Drejtorëve.
- Inicion dhe mbikëqyrë hetimet e veçanta sipas kërkesës.
- Çdo vit rishikon dhe vlerëson përshtatshmërinë e Statutit të Komisionit, duke kërkuar miratimin e Bordit për ndryshimet e propozuara, dhe siguron shpalosjen e duhur siç kërkohet me ligj ose rregullore.
- Konfirmon çdo vit përmbushjen e përgjegjësive të përcaktuara në këtë statut.
- Vlerëson performancën e Komisionit dhe anëtarëve individual të Komisionit çdo vit.

11. KËRKESAT PËR INFORMACIONE

Për të përmbushur obligimet e tija, Komisionit të Auditimit duhet t'i ofrohet informacioni i mëposhtëm, i plotësuar sipas nevojës:

- Vlerësimin e rreziqeve nga KE;
- Raport mbi progresin nga Zyrtari për Auditim të Brendshëm, që përmbledhë:
  - Punën e kryer krahasuar me punën e planifikuar;
  - Çështjet kyçe që dalin nga puna e auditimit të brendshëm;
  - Përgjigjet e menaxhmentit ndaj rekomandimeve të auditimit;
  - Ndërrimet ndaj Planit Vjetor të Auditimit;
  - Ndonjë burim, fushë apo vlerësim i çështjeve që ndikojnë në arritjen e objektivave të auditimit;
  - Raportin mbi progresin nga Zyra Kombëtare e Auditimit (Auditorët e Jashtëm);
- Strategjinë mbi auditimin e brendshëm;
- Planin Vjetor të auditimit të brendshëm;
- Raportet dhe opinionet nga Zyrtari për Auditim të Brendshëm;
- Raportet për sigurimin e cilësisë, për sa i përket funksionit të auditimit të brendshëm;
- Draft-pasqyrat financiare dhe shënimet;
- Raportet mbi çfarëdo ndryshimi në politikën e llogaridhënies;
- Letrën për Menaxhmentin nga Zyra Kombëtare e Auditimit (Auditorët e jashtëm);
- Raportin mbi bashkëpunimin në mes të Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe auditorëve të jashtëm;

12. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të këtij Statuti me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, atëherë dispozitat e ligjeve përkatëse mbizotërojnë.

13. HYRJA NË FUQI

Ky statut hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A.

Përgatitur nga: **Komisioni i Auditimit**	**Miratuar nga:** **Bordi i Drejtorëve**
Kryesues i Komisionit të Auditimit	**Kryesues i Bordit të Drejtorëve**
Ruzhdi ZEQIRI	**Jetmir NUKA**